



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 1010/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P “TERMOKOS” SH.A, me seli në Prishtinë, Rr. ”28 Nëntori”, nr.181, Lagjja Dardania, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, Stadiumi i Qytetit Fadil Vokrri, e përfaqësuar nga “Avokatura Istrefi” SH.P.K., me seli në Prishtinë rr.”Bill Clinton”, H.69, kati 1, Nr.1, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.21/2021 të datës 18.01.2021, të Përmbartuesit Privat Arsim I. Bajraktari nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 15.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, Stadiumi i Qytetit Fadil Vokrri, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.21/2021 i datës 18.01.2021, i Përmbartuesit Privat Arsim I. Bajraktari dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.P “TERMOKOS” SH.A., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.21/2021 të datës 18.01.2021 , me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Kartelës së kontabilitetit nr.61341 të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbartjes së obligimeve të papaguara nga kartela e kontabilitetit të lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin t’ia paguajë kreditorit shumën prej 43,256.77 €, me kamatëvonesë prej 8% në vit duke e llogaritur nga data kur kredia është bërë e arritshme, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit, të realizohen përmes zbatimit të përmbartimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogaritjen e veçantë bankare të Zyrës Përmbartimore, dhe nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbartimi të zbatohet përmes sekuestrimit të

sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor, ndër të tjerash ka theksuar se urdhëri për përmbarrim është i pa bazuar, i kundërligjshëm, i pa lejuar dhe i pa qëndrueshëm, kjo për faktin se nuk është i mbështetur në asnjë dispozitë ligjore. Më tutje ka theksuar se borxhi i paraparë në kartelën e kontabilitetit që kërkohet nga kreditori, është parashkruar konform dispozitave të nenit 360 të Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve pasi që kanë kaluar më shumë se një (1) vit nga data e secilës faturë që është përfshirë në kartelën financiare. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të shfuqizohet Urdhri për përmbarrim.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, ndër të tjerash ka theksuar se prapësimi është ushtruar në kundërshtim me dispozitat e LMD-së dhe dispozitat e LPP-së, dhe se në LMD është e qartë dhe e precizuar se çdo shërbim i ofruar duhet të paguhet dhe në rastin konkret obligimi-detyrimi dhe e drejta krijojnë raporte kreditor- debitor. Më tutje, ka theksuar se propozimi i ushtruar ka të bëjë për periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2020 e cila është brenda afatit ligjor dhe se pretendimi i debitorit se kemi parashkrim konform nenit 360 të LMD-së nuk qëndron, për shkak se tek institucionet dhe bizneset afati i parashkrimit është 3 deri në 5 vite dhe bazohet në dispozitat e nenit 352 dhe 353 të LMD-së. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i ushtruar kundër urdhrin për përmbarrim të anulohet dhe borxhi në vlerë të shumës 43,256.77 € të ekzekutohet.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarrimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarrimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarrimore të përfundohet në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - kartela e kontabilitetit numër 61004, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokument i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përbushjes së detyrimit monetar “, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Kartela e kontabilitetit me numër 61341 në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se një dokument i tillë, bazuar në dispozitën e nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPP-së, nuk është i përcaktuar si dokument i besueshëm.

Bazuar në dispozitën e lartcekur është përcaktuar se në kuadër të dokumenteve të besueshme janë ekstraktet e verifikuara nga librat afariste vetëm sa i përket pagesave të shërbimeve komunale për furnizim me ujë, energji elektrike dhe bartje të mbeturinave. Andaj duke marr parasysh faktin se në rastin konkret propozimi për përmbarim është lejuar sipas një dokumenti – kartelës së kontabilitetit në kuadër të Ndërmarrjes Publike Termokos, gjykata vlerëson se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk konsiderohet dokument i besueshëm dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Megenëse dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbarimor, përkatësisht kartela e kontabilitetit numër 61004, nuk është dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, gjykata nuk i shqyrtoi fare pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në

prapësim dhe duke u bazuar në nenin 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1010/22 datë 15.11.2023

Gjyqtari

Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.